



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Pronësi Industriale – Agencija za Industrijsku Svojinu  
Industrial Property Agency

# **R A P O R T V J E T O R**

## **2 0 1 9**

Adresa: Rr. “Muharrem Fejza” p.n., Lagja e Spitalit 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 200 36 554  
Web: [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net)


## 1. Pranimi i shkresave/aplikimeve

Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar aktivitetin e saj në pranimin e aplikimeve për objekteve të pronësisë industriale: Marka Tregtare; Patenta; Dizajn Industriale; kundërshtime të markave të publikuara; hulumtime të markave tregtare; patentave; ekzaminime të parakohshme; vazhdime; ndryshime; kërkesa për mbajtje në fuqi; dokumente të përparësisë; ndërrim përfaqësuesi; autorizime gjeneralë; autorizime për lëndë përkatëse; ankesa në komision të ankesave; vendime të komisionit të ankesave dhe dokumentacione tjera shtesë.

Gjithsejtë gjatë kësaj periudhe kohore, janë pranuar në zyrën e pranimin të dokumentacionit të API-së **8648** shkresa të ndryshme, të cilat i kemi pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Marka Tregtare aplikime	<b>1731</b>
Patenta aplikime	<b>33</b>
Dizajn Industriale aplikime	<b>25</b>
Emërtimi i Origjinës aplikim	<b>1</b>
Kërkesa për vazhdime të markave tregtare	<b>1025</b>
Kërkesa për ndryshime në regjistër të markave tregtare, patentave dhe dizajneve industriale	<b>1081</b>
Kërkesa për plotësime të Markave Tregtare, taksa për lëshimin e vendimit dhe taksa për lëshimin e certifikatës për Marka Tregtare, pagesa të patentave dhe dizajnit industrial	<b>3407</b>
Kërkesa për kufizimin e listës së produkteve	<b>7</b>
Kërkesa për ekzaminimin e parakohshëm të Markave Tregtare	<b>11</b>
Autorizime	<b>167</b>
Kërkesa për mbajtje në fuqi të patentave	<b>402</b>
Kundërshtime të Markave Tregtare	<b>71</b>
Kërkesa për zgjatje afati	<b>6</b>
Kërkesa për heqje dorë të Markave Tregtare dhe Patentave	<b>19</b>
Kërkesa për korrigjimin e vendimeve dhe aplikimeve	<b>303</b>
Kërkesa për ekstrakt regjistri	<b>15</b>
Kërkesa për vazhdimin e dizajnit industrial	<b>20</b>
Dokumente prioriteti	<b>96</b>
Kërkesa për informacione të Markave Tregtare dhe Patentave	<b>16</b>
Mirëmbajtje vjetore të licencës së përfaqësuesve	<b>39</b>
Ankesa kundër vendimeve të API-së	<b>37</b>
Kërkesa për shfuqizimin e markave tregtare	<b>10</b>
Vendim i komisionit të ankesave	<b>30</b>
Kërkesa për licenca të Markave Tregtare	<b>3</b>
Kërkesa nga pala	<b>81</b>
Kërkesa për vazhdimin e procedurave	<b>12</b>

Grafiku: numri i dokumenteve hyrëse në vite




## 2. Ekzaminimi i Aplikimeve / shqyrtimi i shkresave

### Patenta

Numri i aplikimeve të patentave nuk është i kënaqshëm, kjo për shkakun e mos anëtarimit të Kosovës në EPO, dhe industrisë jo të zhvilluar të tregut të Kosovës, pasi aplikuesit e patentave me rastin e aplikimit në shtete të caktuara, shikojnë së pari interesin e shitjes së patentës së tyre, dhe zhvillimin e industrisë së atij vendi. Me rastin e anëtarësimit të Kosovës në Zyrën Evropiane të Patentave, pritet të shtohen aplikimet e patentave, pasi aplikuesit i kushton më lirë mbrojtja përmes EPO, duke krahasuar me mbrojtjen nacionale që aplikohet tashmë në Kosovë.

Backlog tek patentat nuk ekziston, pasi janë të përfunduara **98.81%** të aplikimeve. Pjesa tjetër ekzaminohen me kohë, pasi tek patentat aplikuesi ka një periudhë 18 mujore, që është standard ndërkombëtar i kohës së qëndrimit të aplikimit pa u publikuar.



Njoftim për plotësimin e aplikacioneve për patentë	<b>24</b>
Njoftim për pagesën e tarifave për lëshimin e vendimit për njohje	<b>19</b>
Vendim për njohjen e patentës	<b>22</b>
Vendim të tërësishme – pjesërisht të patentave	<b>12</b>
Vendim për ndryshim të aplikacioneve-vendimeve të patentave (emrit, pronarit, adresës)	<b>13</b>
Vendim për refuzimin e aplikacioneve për patentë	<b>9</b>
Hapa në sistemin IPAS	<b>5003</b>
User doc acceptance, pranimi i mbajtjeve në fuqi pas kontrollimit, dhe i dokumenteve tjera përcjellëse të hyra si user dokumente për aplikimet dhe regjistrin e patentave	<b>379</b>
Mbatje në fuqi të kontrolluara dhe chekuara	<b>402</b>

Tabela 2. Statistika vjetore të sektorit të patentave 2019

### Marka Tregtare

Numri i aplikimeve për markave tregtare ka shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak, përfshirë rritjen e numrit të aplikimeve për marka tregtare nga aplikues vendor për **13.65%**. Rritja e numrit të aplikimeve vendore i atribuohet aktiviteteve të realizuar nga API për ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e mbrojtjes së produkteve dhe shërbimeve me markë tregtare, si seminare, konferenca dhe promovim në media, të mbajtura gjatë këtij viti kalendarik.

Sa i përket back log të markave tregtare, API gjatë 2019 ka shënuar progres në reduktimin e back log, nga **91.59%** të kryera në vitin 2018, është arritur në **94.30%** në vitin 2019, kjo përkundër pranimit aplikimeve të reja. Janë ekzaminuar të gjitha markat e reja të pranuar deri në muajin Nëntor, ndërsa në procedurë konsiderohen 1809 aplikime të MT, të cilat janë në procedurë të publikimit, pritjes së plotësimin, në pritje të pagesës për regjistrimin e MT dhe të tjera.

Konsiderohet se sivjet ka përfunduar back log i aplikimeve të markave tregtare, pasi që kanë përfunduar ekzaminimet e aplikimeve të reja deri në muajin Nëntor, dhe ato tashmë janë në procedurë të regjistrimit. Si back log mbeten vetëm lëndët të cilat kanë pranuar kundërshtime pas publikimit të tyre.

Gjatë vitit 2019 API ka ndarë një buxhet shtesë për rekrutimin e stafit teknik për përgatitjen e vendimeve, certifikatave, ftesave dhe mirëmbajtjen e skanimit të dokumenteve hyrëse dhe dalëse, pasi stafi profesional është i fokusuar në ekzaminimin e aplikimeve sipas kushteve absolute dhe relative, ndërsa pjesa e stafit e rekrutuar është fokusuar në punët teknike deri në regjistrimin e MT.




Tabela punuese e markave tregtare gjatë vitit 2019

Vendime për regjistrimin e markave tregtare	<b>1900</b>
Publikime të markave tregtare pas ekzaminimit	<b>2129</b>
Njoftime për plotësimin e aplikacioneve	<b>149</b>
Njoftime për heqje dorë të markave tregtare	<b>30</b>
Vendime për ndryshimin në regjistër të markave tregtare	<b>948</b>
Vendime për vazhdimin e markave tregtare	<b>1405</b>
Lëshimi i certifikatave për marka tregtare	<b>1834</b>
Ftesë për pagesën e vendimit për markë tregtare	<b>1864</b>
Ekstrakte regjistri	<b>13</b>
Vendime për refuzimin e MT	<b>446</b>

Tabela 3. Statistika vjetore të sektorit të markave tregtare gjeneruar përmes IPAS


### Dizajni Industrial

Numri i aplikimeve të dizajnit industriale ka shënuar rritje. Si tek patentat dhe tek dizajni industrial numri i aplikimeve nuk është i knaqshëm, kjo për shkakun e zhvillimit industrial dhe produkteve të reja në Kosovë. Me dizajn industrial mbrohet dukja e jashtme e produktit, dhe duhet njëjshu që produkti të ketë karakter individual, dmth të jetë një lloj risie në fushën përkatëse.

Kanë përfunduar shqyrtimet e aplikimeve të dizajneve industriale deri në vitin 2018, mbeten të shqyrtohen aplikimet e dizajneve industriale të pranuar gjatë vitit 2019.

Tabela punuese e dizajnit industrial gjatë vitit 2019.

Njoftime për plotësimin e Dizajnit Industrial	<b>24</b>
Vendime për vazhdimin e Dizajnit Industrial	<b>4</b>
Vendime për regjistrimin e Dizajnit Industrial	<b>28</b>
Vendim për refuzimin e Dizajnit Industrial	<b>4</b>
Ftese për pagesën e regjistrimit të DZ	<b>82</b>



### Përmbledhje e tabelave punuese të sektorëve

Nga të dhënat statistikore të nxjerra në sistemin IPAS del se zyrtarët e API-së gjatë vitit 2019 kanë kryer gjithsejti **30903** hapa në sistem, hapat përfshijnë kalimin nga një procedurë e ekzaminimit në procedurën tjetër.

Janë printuar **8845** dokumente dalëse, vendime, certifikata, ftesa, për përfundimin e proceseve të shqyrtimit të aplikimeve.

Gjatë këtij viti janë skanuar, indeksuar dhe dërguar në server, **14787** shkresa hyrëse dhe dalëse, që e bën procesin e pranimit dhe lëshimit të dokumenteve të elektronizuar.

### **3. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare dhe kërkesat për deklarim të shfuqizimit**

Është e domosdoshme që të pranohet dhe miratohet propozimi për ri-strukturimin e API-së, ku do të kishte sektor të veçantë e cila merret me shqyrtimin e kundërshtimeve dhe kërkesave për shfuqizime. Deri më tani janë pranuar **560** kundërshtime të markave tregtare dhe **40** kërkesa për shfuqizimin e markave tregtare të regjistruara.

Sipas raportit të përgatitur nga projekti i kaluar i EU, 1 ekzaminues apo ekspert, mund të kryej deri në 66 kundërshtime në bazë vjetore (raporti Mr. Hallgren datë 01/11/2014). Në API ekzaminuesit e tashëm janë të dedikuar për ekzaminimin e aplikimeve të reja. Miratimi i rregullores së propozuar do të krijonte bazën e shëndoshë për shqyrtimin e tyre.

#### 4. Treguesit Gjeografik

Është përgatitur Draft Rregullorja e Punës për Komisionin e Eksperteve për Produkteve Bujqësore dhe Artikujve Ushqimore ne fushën e Treguesve Gjeografikë.

Me mbështetjen e projektit të EU, është organizuar Punëtorja për Treguesit Gjeografikë për Verërat.

Është mbajtur seminari për specifikimin e produkteve të Djathit të Sharrit, mbështetur nga projekti i EU për mbështetje Tregtinë në Kosovë. Në këtë seminar u prezantua drafti i Specifikimit të Djathit të Sharrit dhe Zona Gjeografike. (Dhjetor)




#### 5. Publikimi i Buletinit të API

Agjencia për Pronësi Industriale gjatë këtij viti ka publikuar **11** Buletine të Pronësisë Industriale me **7994** objekte të pronësisë industriale të cilat përfshijnë: aplikime të markave tregtare, vendime për regjistrimin e markave tregtare, ndryshimet në regjistër dhe vazhdimet e markave tregtare. Agjencia ka në web faqen e saj dhe regjistri online ku publiku mund të kërkoj për objekte të pronësisë industriale. Këto shërbime e bëjnë API institucion transparent dhe në linjë me zyrat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare

## 6. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish dhe Web faqe

Është përmirësuar qasje online e palëve të interesuar për kërkime në regjistër të markave tregtare. Tashmë sistemi online WipoPublish është në funksion dhe është i përditësuar çdo ditë kalendarike.



Ky sistem i ofruar nga WIPO mundëson që palët të bëjnë kërkime për marka tregtare dhe të shohin statusin e aplikimeve të tyre, kjo krijon transparence tek palët pasi ato mundën në çdo kohë të verifikojnë rrjedhjen e shqyrtimit të lëndës së tyre.

API gjatë vitit 2019 ka publikuar aktivitetet kryesore në web faqen e saj, janë krijuar **31** lajme dhe publikuar në web faqen [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net).



## 7. Seminare & Aktivitete

### Janar:

Është organizuar takimi me përfaqësuesit e autorizuar të Pronësisë Industriale, ku është prezantuar Raporti Vjetor i Agjencisë, dhe është diskutuar rreth sfidave dhe të arriturave përgjatë vitit që lamë pas.



Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga Oda Amerikane e Kosovës me temën “Pronësia Intelektuale në Kosovë dhe Bashkim Evropian”. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale, Z. Gashi, ishte pjesë e panelit. Z. Gashi foli mbi gjendjen e pronësisë industriale në Kosovë, të arriturat dhe sfidat në implementimin e obligimeve të dalura nga MSA.



Në këtë muaj kanë përfunduar procedura e rekrutimit për zyrtaren e lartë për ekzaminim.

## Shkurt:

Një delegacion i Agjencisë për Pronësi Industriale, i kryesuar nga Drejtori, Z. Gashi, qëndroi për vizitë zyrtare në Turqi. Gjatë qëndrimit delegacioni u prit nga Drejtori i Zyrës për Patenta dhe Marka të Turqisë, Prof. Dr. Habip ASAN. Palët u dakorduan për të arritur një marrëveshje bashkëpunimi, me fokus forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve të API-së. Marrëveshja do të përfshi edhe bashkëpunimin e cekuar në nenin 103 të Ligjit për Patenta. Zyrtarët e Zyrës për Patenta dhe Marka të Turqisë organizuan prezantimet sektoriale për objektet e pronësisë industriale, ku u prezantuan praktikat më të mira të shqyrtimit të objekteve të PI.



Pjesëmarrja në Takimin e Task Forcës Kundër Piraterisë ku temë e diskutimit ka qenë bashkëpunimi ndërinstitucional dhe hapat e veprimit të mëtutjeshëm për realizimin e planit të Task Forcës kundër Piraterisë.

## Mars:

Është bërë raportimi në Komisionin Evropian për MSA, raporti mbi pronësinë industriale, pjesë e Nën-komitetit të MSA për Tregun e Brendshëm, Konkurrencën dhe Mbrojtjen e Konsumatorit.

Është mabjtur takimi i Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale. Në takim është prezantuar në pika të shkurta mandati i ri i Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale sipas Vendimit të ri të Qeverisë me numër 10/73 datë 30.10.2018. Është diskutuar plani i veprimit, statuti i ri i Këshillit Shtetëror dhe pjesëmarrja e anëtarëve të ri.



**Prill:**

Në vazhden e organizimit të aktiviteteve për shënimin e Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, Agjencia për Pronësi Industriale, në bashkëpunim me Kolegjin UBT, organizoi një ligjëratë mbi pronësinë industriale në Qendrën e Transferit të Teknologjisë pranë këtij Kolegji. Ligjëratën e mbajti Z. Isa Dukaj, i cili e përfaqësoi Agjencinë.





Është mbajtur takimi me Anëtarët e Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale, ku është miratuar statuti i ri i këtij Këshilli. Statuti do të shërbejë si dokument me të cilin do të funksionon Këshilli Shtetëror për Pronësi Intelektuale.



Në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, Agjencia për Pronësi Industriale organizoi ligjërate mbi të drejtat e pronësisë industriale në Kosovë. Ligjëratën para studentëve e mbajti Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, Z. Nezir Gashi.



Aktivitet informues në Panairin Expokos dhe panairin e Edukimit, ku u informuan bizneset mbi rëndësinë e mbrojtjes së produkteve të tyre me pronësi industriale. Gjatë vizitave, API takoi biznese të ndryshme të cilat i informoi mbi rëndësinë e mbrojtjes së emrit apo produkteve të tyre me pronësi industriale, qoftë si markë tregtare, patentë apo dizajn industrial.



Seminar me biznese në Odën e Afarizmit të Kosovës, tema e seminarit “Rëndësia e Mbrojtjes së Pronës Industriale”





Ligjërata në Fakultetin Juridik të Universitetin të Prishtinës me temën “Pronësia Industriale në Kosovë”



Ndeshje futbollli në mes Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe Zyrës për të Drejtat e Autorit, me moton e ditës së PI “Sporti dhe IP”.



Përmes organizimit të Konferencës Kombëtare “Të Drejtat Pronësore Intelektuale”, u shënuar Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale.



Promovim në media, Radio Kosova, ku Drejtori i Agjencisë Z. Gashi foli mbi rëndësinë e mbrojtjes së produkteve me pronësi industriale.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Pronësi Industriale, Z. Gashi, ishte pjesë e panelit në programin e Radio Televizionit 21, “Start UP”, ku foli mbi rëndësinë e mbrojtjes së produkteve dhe shërbimeve me pronësi industriale.



Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Ministria e Drejtësisë, tema Drejtësia komerciale “Drejtësia në Zhvillim”

Agjencia për Pronësi Industriale ka qenë pjesmarrëse në Konferencën Botërore mbi patentimin e Blockchain, organizuar nga WIPO

### **Maj:**

Agjencia ka marrë pjesë si e ftuar në shënimin e Ditës Botërore të Metrologjisë

Me mbështetjen e projektit të twinningut “Përkrahja e Institucioneve të Kosovës për implementimin e MSA”, u mbajt trajnimi 3 ditor në fushën e pronësisë industriale. Gjatë trajnimit, për të cilën u angazhuan ekspertët e fushës së IP nga Kroacia, u diskutuan me pjesëmarrësit çështjet kryesore të mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale, patentat, markat tregtare, dizajni industrial, topografit e qarqeve të integrueme dhe sekretet tregtare.



### **Qershor:**

Kanë përfunduar procedurat për rekrutimin e zyrtares për marka tregtare dhe zyrtarit për të hyra financiare pranë Agjencisë.

### **Korrik:**

Është mbajtur takimi me lideren e projektit të EU “Mbështetje për Pronësisë Intelektuale në Kosovë, ku është shqyrtuar plani i projektit.



Drejtori i Agjencisë për Pronësi Industriale, Z. Nezir Gashi, mbajti një ligjëratë në Akademinë Verore për Ndërmarrësi dhe Inovacion organizuar nga Kolegji UBT.



#### **Shtator:**

Është mbajtur takimi i anëtarëve të komisionit për Tregues Gjeografik dhe përfaqësuesit e EU- INAO –së, Znj, Stepfanie Lequin dhe EU- INAO, Z.Gilles Vaudelin, ekspert në përcaktimin e zonave Gjeografike EU- INAO. Gjatë takimi u diskutua mbi fushën e treguesit gjeografikë dhe produktet potenciale për tu mbrojtur me tregues gjeografikë.

Pjesëmarrje në trajnimin 3 ditor të organizuar nga IKAP për Ciklin e Menaxhimit të Projekteve.

Me ftesë të Zyrës Turke për Patenta, Agjencia për Pronësi Industriale ka marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Inovacionit organizuar në Istanbul.

## Tetor:

Është mbajtur takimi i parë i komitetit drejtues të projektit “**EU Support for Intellectual Property Rights System in Kosovo**”. Në takim u diskutua mbi planin e projektit dhe miratimin e tij.



Pjesëmarrje në Trajnimin: “Ligji për zyrtaret publik, risitë dhe ndryshimet në administratën publike/shërbimin civil”.

Pjesëmarrje ne seancën-shqyrtimin kryesor në Gjykatën Themelore në Prishtine (Padia kundër Komisionit lidhur me aplikacionin 228/2016 për markë tregtare).

Është përgatitur plani narrativ për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Agjencinë për Pronësi Industriale ka marrë pjesë në Konferencën informuese “Ditët e Biznesit të Vogël 2019” i organizuar nga KIESA dhe Komuna e Gjakovës. Në konferencë morën pjesë: përfaqësues nga institucionet qendrore dhe lokale, MZHR, MIN, ATK, Dogana, KEDS si dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit të kësaj ane.

## Nëntor:

Pjesëmarrje ne vizitën studimorë në Luxembourg, të mbështetur nga projekti LuxDev. Gjatë kësaj vizite studimore u trajtuan tema të ndryshme mbi ekzaminimin e aplikimeve të markave tregtare në bazë të praktikave europiane.



Është përgatitur dhe dorëzuar plani paraprak i prokurimit për vitin 2020. Agjencia ka parashikuar realizimin e shërbimeve kontraktuese përmes prokurimit.

Trajnim – Modeli i Kostimit Standart, Matja dhe zvogëlimi i barrës administrative

Pjesëmarrje në grupin punues për draftimin e Udhëzimit Administrativ për Emrat Zyrtar dhe Emrat Tregtar.

Pjesëmarrja në sesionin trajnimi dhe shkëmbimi i përvojave evropiane mbi praktikën e mira të rekrutimit në shërbimin publik. Trajnimi iu dedikohet zyrtarëve të lartë të shërbimit civil të Kosovës, i cili do të mundësojë një debat lidhur me rekrutimin në administratën publike mbi bazën e shembujve konkretë të përvojës Franceze, e organizuar nga MAP përmes institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në bashkëpunim me Ambasadën e Francës në Kosovë dhe Shkollën Franceze për Administratë Publike (ENA).

Janë mbajtur 2 takime me ekspertin e projektit “EU Support for Intellectual Property Rights System in Kosovo” për ri-shikimin dhe draftimin e Ligjit për Patenta dhe Dizajnit Industrial.

Agjencinë për Pronësi Industriale ka marrë pjesë në Konferencën informuese “Ditët e Biznesit të Vogël 2019” i organizuar nga KIESA dhe Komuna e Ferizajt. Në konferencë morën pjesë: përfaqësues nga institucionet qendrore dhe lokale, MZHR, MIN, ATK, Dogana, KEDS si dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit të kësaj ane.

### **Dhjetor:**

Është mbajtur trajnimi dy ditor “Pronësia Intelektuale në aspektin Civil dhe Penal”. Ky trajnim është organizuar nga Agjencia, Zyra për të Drejtat e Autorit dhe është mbështetur nga GIZ. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë prokurorë, gjyqtarë, inspektorë të tregut dhe policë.



Agjencia për Pronësi Industriale ka marrë pjesë në Kongresin Botërorë të Brendeve e cila u mbajt në Frankfurt.

Është mbajtur takimi me ekspertin e angazhuar nga projekti “EU Support for Intellectual Property Rights System in Kosovo” për ri-shikimin dhe përgatitjen e draftit për ndryshimin e Ligjit për Marka Tregtare.

U mbajt takimi i radhës së Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale. Në takim morën pjesë anëtarët e këtij Këshillit nga Dogana e Kosovës, Policia, Gjykata, Inspektorati i Tregut, Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Në takim u prezantuan në pika të shkurtra raporti vjetor i Agjencisë për Pronësi Industriale, për të cilën foli, Drejtori Z. Gashi, i cili theksoi se kemi rritje të numrit të aplikimeve për marka tregtare nga aplikues të Kosovës. Kjo rritje i atribuohet aktiviteteve të realizuar nga API për ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e mbrojtjes së produkteve dhe shërbimeve me markë tregtare, si seminare, konferenca dhe promovim në media, të mbajtura gjatë këtij viti kalendarik.





Një delegacion i kryesuar nga Drejtoresha e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Znj. Ledina Beqiraj, qëndroi për vizitë në Agjencisë për Pronësi Industriale. Gjatë takimit u diskutuan mënyrat e bashkëpunimit të zyreve homologe në fushën e pronësisë industriale, bashkëpunim ky i formalizuar me marrëveshjen e bashkëpunimit, arritur gjatë këtij vitit 2018. Qëllimi i bashkëpunimit është të arrihen objektivat të cilat përfshijnë shkëmbimin e ndërsjelltë të eksperiencës, informacionit dhe publikimeve në fushën e pronësisë industriale, bashkëpunimit reciprok në harmonizimin e legjislacionit, politikave straregjike dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e pronësisë industriale.


Zyrat u pajtuan që të krijojnë grupe punuese të cilat do të merren me përgatitjen e një strategjie për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta. Aktivitetet e përbashkëta do të fokusohen kryesisht në promovimin e pronësisë industriale si dhe forcimin e sistemeve kombëtare të pronësisë industriale.



## 8. Të hyrat financiare

Agjencia realizon të hyra të cilat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë në shumën **399,765.00** euro. Për realizimin e këtyre të hyrave janë gjeneruar **7094** fletëpagesa. API ka sistemin e saj online të gjenerimit të fletëpagesave përmes web faqes së saj, ky shërbim ka mundësuar zvogëlimin e kohës për aplikimin dhe qasje në shërbimet e API-së.

Ky zvogëlim i të hyrave të cilat janë paraqitur mëposhtë ka ardhur si pasojë e rënies së kërkesave për vazhdimin e markave tregtare. Viti 2018 ishte viti i 10 për aplikimet e ardhura në vitin 2008, që korrespondon me vazhdimin pas 10 vite të markave tregtare. Në vitin 2018 API ka pranuar 3349 vazhdime, ndërsa në vitin 2019 ka pranuar vetëm 1025 kërkesa për vazhdimin e markave tregtare, pra një rënie për **69.3%**.



## 9. Sfidat

API-së gjatë një vitit kalendarik i shtohen mbi 12000 procedura apo hapa në sistemin IPAS, për menaxhimin e dokumenteve hyrëse. API ka ndarë për vitin 2020 një buxhet për rekrutimin e zyrtarëve për përgatitjen dhe gjenerimin e vendimeve, certifikatave, ftesave, mirëmbajtjen e arkivës, mirëmbajtjen e skanimit dhe detyrat tjera teknike brenda Agjencisë. API kërkon, rekrutimin e stafit të përhershëm, pasi për ekzaminimin e objekteve të pronësisë industriale duhet trajnim dhe përgatitje e cila kërkon kohe dhe investim, ndryshimi i shpeshtë i stafit teknik krijon boshllëk dhe humbje e kohës për trajnimin e zyrtarëve të rinj.

Anëtarësimi në Organizatën Botërore për Pronësi Intelektuale dhe në mekanizmat rajonal si EUIPO dhe European Patent Office duhet të jetë prioritet i lartë për vitin 2020 dhe duhet të ri alokohen mjetet e nevojshme për këtë takime lobimi për gjetjen e mënyrave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të pronësisë intelektuale.

Siç edhe është e ditur API në organiken e tanishme ka vetëm një sektor atë të Patentave, ndërkohë që është propozuar draft organogrami në përbërjen e të cilës janë të përfshira dy (2) drejtori, katër (4) Sektor, dhe ku parashihet shtimi i numrit të stafit me mbi 20 punëtor, krejt kjo më qëllim të funksionimit normal të Agjencisë, në të kundërtën API, do të ballafaqohet më vështirësi në funksionimin normal në kryerjen e detyrave dhe obligimeve sipas ligjeve në fuqi.

Promovimi mbetet një sfidë për Agjencinë, mungesa e zyrtarit përkatës dhe mjeteve për realizimin e aktiviteteve për qëllime e promovuese.

Miratimi i Strukturës Organizative të API-së, të propozuar si pjesë e Rregullores së MTI-së, do të krijonte kushte për shqyrtimin me kohë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve tek palët.

## 10. Donatorët

Gjatë këtij viti Agjencia për Pronësi Industriale është mbështetur nga disa donator përmes programeve të tyre:

1. IPA 2014 EU Twinning Project “Mbështetje Institucioneve të Kosovës për implementimin e MSA” – projekti ka përfunduar
2. Projekti i EU IPA 2016 “Mbështetje për zhvillimin e Tregtisë në Kosovës”, i cili ka mbështetur aktivitetet në fushën e treguesve gjeografikë (projekti përfundon më 11/07/2020)
3. IPA 2017 Project “ EU Support for the Intellectual Property Rights in Kosovo”, projekti 3 vjeçar i filluar në Tetor 2019, përfundon më 18 Tetor 2022.
4. Technical Assistance by Luxembourg-Development – projekti mbështet disa aktivitete në forcimin e kapaciteteve.
5. GIZ
6. Ambasada Franceze në Kosovë